



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:131603

Datë: 03.10.2022

Numri i dokumentit: 03484424

PPP.nr.100/2022

GJYKATA THEMELORE MITROVICE-DEGA SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, si përmbarimore me gjyqtarin Hajrullah Aruqi dhe me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Shala-Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit KRM “Uniteti” sh.a Mitrovicë Rr. V.Dragaj pn, kundër debitorit J., O., nga fshati ..., komuna Skenderaj, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 164.40 €, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e Përmbarimit, gjykata jashtë seancës me datën 03.10.2022, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit J., O., nga fshati ..., komuna Skenderaj, ashtu që:

II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri mbi lejimin e Përmbarimit P.nr.391/22 dt.12.03.2022 për periudhën 30.04.2018 deri me 31.12.2020 në shumë prej 96,90€, dhe **OBLIGOHET** debitori J., O., nga fshati ..., komuna Skenderaj, në emër të borxhit për mbeturina për periudhën kohore 01.03.2021 e gjer me 01.03.2022, t’ia paguaje shumën prej 67.50 €, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke filluar nga pranimi i këtij vendimi e gjer në pagesën definitive të detyrimit.

A r s y e t i m

Kreditori, KRM” Uniteti” sh.a Mitrovicë Rr. V.Dragaj pn, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit J., O., nga fshati ..., komuna Skenderaj, lidhur me pagesën e borxhit për mbeturina për periudhën kohore 30.04.2018 e gjer me 01.03.2022, në shume totale prej 164.40€, me kamate prej 8% vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës në afat 7 ditor, në të kundërtën të behet bllokimi i llogarive bankare, regjistrimi, vlerësimi, sekuestrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuara në propozimin për përmbarim të dt.01.03.2022.

Organi përmbarues me Urdhrin P.nr.391/22 dt.01.03.2022, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit te kreditorit.

Debitori ne afatin ligjor ka parashtruar prapsim me shkrim, me arsyetimin se nuk kemi kontratë me debitorin për bartjen e mbeturinave, po ashtu nuk kemi pranuar asnjë fatur nga ana e kreditorit se kemi një shume te tillë për pagesë, borxhi me të cilin ngarkohem sipas nenit 360 të Ligjit për Mardhënje të Detyrimeve ka arritur parashkrimin, Andaj kërkojmë nga gjykata qe Urdhrin ta Hedh Poshtë si të pa bazuar.

Kreditori në afatin e parashikuar ligjor ka bërë përgjigje në prapësimin e debitorit, me arsyetim se duke u bazuar dhe mbështetur në nenin 21 të LPP-së përcaktohet qartë se procedura përmbarimore mund të zhvillohet vetëm në bazë të dokumentit përmbarues apo titulus exectuions. Procedura përmbarimore ka filluar dhe është e bazuar në faturat apo ekstraktet e Kreditorit KRM"Uniteti" Sh.A të cilat i përmbajnë të gjitha të dhënat e sakta lidhur me debitorin duke bazuar dhe mbështetur ne nenin 40 të LPP-së. Faktete relevante të lartëcekura, faturat dhe ekstraktet si dokument i besueshëm, Andaj kërkojmë qe prapsimi i debitorit të refuzohet në tërsi si i pabazuar dhe urdheri te mbetet ne fuqi duke u aprovuar.

Gjykata Themelore Mitrovicë-Dega Skenderaj, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohet përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit në prapësimin e parashtruar, lidhur me atë ku ka kërkuar qe të aprovohet i njëjti si i bazuar dhe të anulohet në tersi si jo ligjor dhe i parregullt urdhri mbi lejimin e përmbarimit dhe të prishen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore me arsyetimin se propozimi për përmbarim nuk i përmban kushtet ligjore të kërkuar konform nenit 38 par.1 te LPP-së.

Po ashtu dokumenti me te cilin është lejuar përmbarimi nuk i ka tiparet e përmbarueshmëris sepse ne mes kreditorit dhe debitorit nuk ka pasur raport juridik kontraktual, pretendimet e lartcekura gjykata i refuzoj si të pa bazuara për fakti se në shkresat e lëndës gjendet fatura e cila i është dorëzuar edhe debitorit ku kjo dëshmohet me fletkthesën e dt. 28.03.2022 ku se bashku me propozimin për përmbarim ju ka dorëzuar edhe fatura e qe ne rastin konkret ka shërbyer si dokument i besueshëm dhe e përshtatshme për përmbarim konform nenit 29 par.1.3, 37 dhe 38 par.1 dhe 2 te LPP-së.

Sa i përket mos dërgimit te faturave në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se debitori ka parashtruar ndonjëherë ankesë lidhur me këtë çështje të kreditori, andaj te njëjtat pretendime nuk qëndrojnë dhe janë të pa bazuara.

Sa i përket pretendimeve lidhur me parashkrimin, gjykata të njëjtat pretendime i aprovoj pjesërisht si të bazuara, pasi që i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori, J., O., nga fshati ..., komuna Skenderaj për periudhën kohore 01.04.2018 deri me 31.12.2020 është borxh i parashkruar, konform nenit 360, par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Kurse sa i përket borxhit për periudhën kohore 01.03.2021 e gjer me 01.03.2022 gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 360, par.2 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Ku parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjate një viti, fillon të rrjedhe në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura ne vitin 2021, afati I parashkrimit ka filluar të rrjedh me 01.01.2022, dhe në rastin konkret nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit për faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar me datën 01.03.2022, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 369 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Sa i përket kamatës së aplikuar për detyrimin e aprovuar si në pikën II të dispozitivit, gjykata u referua nenit 382, par.1 dhe 2 te LMD-së.

Gjykata konform nenit 17 te LPP-së, përshtatshëmish aplikoj dispozitat ligjore te LMD-së

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, dhe konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1.2 dhe 1.3 dhe par.3, 35, 69, 71 e 73 par.3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, lidhur me nenin 360 par.1 dhe 2, dhe 368, 369 dhe 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA SKENDERAJ
DEPERTAMENTI I PËRGJITHSHËM
PPP.nr.100/2022, dt: 03.10.2022.

GJ Y Q T A R I
Hajrullah Aruqi

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.